



“HERONJTË E PADUKSHËM”

Përmes aktivitetit “Heronjtë e padukshëm”, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) shpalos punën e zyrtareve të ANJF-së përmes intervistave me zyrtarët ligjor të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas. Njihuni me Fjorda Mujollar, zyrtare për ndihmë juridike falas, përmes intervistës së realizuar.



Fjorda Mujollar është zyrtare ligjore e ndihmës juridike falas në zyrën rajonale në Prizren. Sipas Fjordës: “Ndhimja juridike falas është shumë më shumë se një shërbim ligjor; ajo është një mjet i fuqishëm për të ndihmuar ata që ndjehen të privuar nga drejtësia. Për profesionin tonë, besoj se ofrimi i kësaj ndihme është një detyrë morale dhe një rrugë për të kontribuar në përmirësimin e shoqërisë tonë”.

Fjorda filloi rrugëtimin e saj në Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) në vitin 2008 me plotë vendosshmëri dhe përkushtim. Për më shumë se 15 vite ajo shërben me përkushtim dhe zell në këtë detyrë, duke ofruar ndihmë juridike falas për ata që nuk kanë mundësi financiare për të zgjedhur problemet e tyre ligjore.

Përveç punëve me palët e ANJF-së, Fjorda është anëtare e mekanizmit kundër dhunës në familje që nga viti 2016, në rajonin e Prizrenit, që mbulon edhe komunat e Mamushës dhe Dragashit. Një numër i madh i rasteve që ajo ka trajtuar janë raste të dhunës në familje. Për Fjordën puna me viktimat e dhunës në familje i jep një ndjenjë të pashpjegueshme, në veçanti kur ajo është në gjendje të ofrojë ndihmën e saj për gratë dhe fëmijët që janë në kërcënim të dhunës. Raportet e veçanta që ajo ka krijuar me nënat vetëushqyese dhe fëmijës, Fjorda nuk do t'i harrojë kurrë. Ajo është bërë një burim shprese dhe inkurajimi për ta.

Një nga karakteristikat kryesore të shërbimeve të Fjordës është ofrimi i ndihmës juridike pa dallim etnie, gjinie dhe feje. Ndonëse Komuna e Prizrenit njihet si një komunë multietnike, ajo nuk bën dallim dhe ofron shërbimet në tre gjuhë: shqip, turqisht dhe boshnjakisht. Ky ndihmesë në dispozicion në gjuhët e tyre të preferuara ndihmon qytetarët të ndjehen të kuptuar dhe të përkrahur në momentet e tyre më të vështira gjatë përballjes me probleme ligjore.

Zonja Fjorda është gjithashtu ofron përkrahje të vazhdueshme për të drejtat e grupeve të marginalizuara. Ajo është ballafaquar me zhgënjimin e palëve të ndryshme, si pasiguria dhe të cilave u janë refuzuar të drejtat e tyre nga institucionet e ndryshme. Ajo nuk është vetëm një zyrtare ligjore, por një burim i përkrahjes emocionale dhe mbështetjes në momentet më të vështira. Ajo është një shembull frymëzues për ne të gjithë, treguesi i fuqisë së një individ të përkushtuar për të ndryshuar botën për të mirën e të tjerëve.